



REPUBLIKA E SHQIPERISE

**MINISTRIA DREJTESISE
MINISTRI**

URDHER Nr. 360 Date 05/09/2013

**PER
MENYREN E NJOFTIMIT ELEKTRONIK TE AKTEVE GJYQESORE**

Ne mbeshtetje te nenit 102, pika 4 e Kushtetutes, te nenit 7, pika 2 te Ligjit Nr. 8678, date 14.05.2001, "Per organizimin dhe funksionimin e Ministrise se Drejtesise", i ndryshuar, si dhe nenit 141 te Ligjit Nr. 8116, date 29.3.1996 "Kodi i Procedures Civile i Republikes se Shqiperise", te ndryshuar,

URDHEROJ :

1. Njoftimi elektronik, si nje nder menytrat e njoftimit te akteve gjyqesore behet nga nepunesi gjyqesor nepermjet mjeteve te komunikimit elektronik dhe ndiqet nga gjyqtari ose kryetari i trupit gjykues te ijeshajes, i cili kontrollon dhe kujdeset per procesin e zhvillimit te tij ne perputhje me rregullat e parashikuara ne Kodin e Procedures Civile.
2. Thirrja ne gjykate, nepermjet leterthirrjes, urdherohet te behet nepermjet njoftimit me mjete te komunikimit elektronik, ne rast se fmohet e dobishme nga gjykata dhe kur pala ka dhene pelqimin paraprak sipas rregullave te parashikuara ne Kodin e Procedures Civile.
3. Njoftimi elektronik behet me mjete te komunikimit elektronik qe mundesojne marrjen e konfirmimit per mberritjen/marrjen e njoftimit, ose nese kjo eshte e pamundur personi i thirrur duhet te konfirmoje personalisht qe ka marre njoftimin.
4. Njoftimi elektronik i paditesit, ose perfaqesuesit te tij, behet vetem ne rastin kur ne kerkesepadi jane paraqitur te dhenat elektronike te kontaktit, si dhe deklarata e pranimit te njoftimit me mjete te komunikimit elektronik.
5. Ne rast se vertetohet nga nepunesi gjyqesor se paditesi, ose perfaqesuesi i tij, ka ndryshuar te dhenat elektronike te kontaktit te tij, dhe gjykata nuk eshte njoftuar per te dhenat e reja elektronike te kontaktit te tij, ne perputhje me detyrimin ligjor te parashikuar ne nenin 158/a te Kodit te Procedures Civile, njoftimi behet ne forme shkresore ne nje kohe sa me te shpejte. Ne rast se edhe te dhenat e adreses se paditesit, ose perfaqesuesit te tij, kane ndryshuar dhe gjykata edhe ne kete rast nuk eshte njoftuar nga paditesi, ose perfaqesuesit i tij, per adresen e re, ne kushtet e mosrespektimit te detyrimit per njoftimin e te dhenave te reja nga paditesi, pretendimet e tij lidhur me pavlefshmerine e njoftimit do te konsiderohen te papranueshme.

6. Per njoftimin e vendimit te gjykates ndiqen te njejtat rregulla te parashikuara ne pikat 1,2,3,4 dhe 5 te ketij urdhri.
 7. Ne cdo rast njoftimi behet duke respektuar legjislacionin per komunikimet elektronike dhe mbrojtjen e te dhenave personale.
 8. Njoftimi pasqyrohet ne nje procesverbal te posafem i cili hartohet dhe permban elementet e parashikuara ne nenin 141 te Kodit te Procedures Civile, si dhe behet pjese e dosjes gjyqesore.
 9. Per arkivimin dhe ruajtjen e procesverbalit te njoftimit ndiqen te njejtat rregulla si per ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit te seances gjyqesore te mbajtur ne formen e nje permbledhje me shtypshkrim apo doreshkrim.
 10. Ngarkohen gjykatat e shkalles se pare dhe gjykatat e apelit per zbatimin e ketij Urdhri.
 11. Ngarkohet Drejtoria e Pergjithshme e Ceshtjeve te Drejtesise ne Ministrine e Drejtesise per ndjekjen e zbatimit te ketij urdhri.
 12. Ngarkohet Sekretari i Pergjithshem per njoftimin e ketij urdhri.
- Ky urdher hyn ne fuqi menjehere dhe botohet ne Fletoren Zyrtare.

MINISTRI
EDUARD HALIMI